



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 22491 prot.

Shkodër, më 03.11. 2025

VENDIM

Nr. 63, datë 31.10.2025

“PËR MIRATIM SHITESË TË PLANIT NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 76, DATË 19.12.2024, “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PËRFUNDIMTAR 2025–2027 TË BASHKISË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR”.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54, shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; të nenit 20, pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; të ligjit nr. 115/2024, datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar; të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, i ndryshuar; të Udhëzimit nr. 10, datë 12.07.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”; të Marrëveshjes së partneritetit datë 20.08.2025 ndërmjet Komunës Ostuni si partner lider dhe Komunës Trivento, Bashkisë Shkodër dhe Komunës Ulqin si partnerë; të VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin “REUSEFUL–Promovimi i reduktimit të mbetjeve përmes qendrave të ripërdorimit në zonën e Adriatikut të Jugut”. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA III) Interreg IPA Adriatiku Jugor 2021/2027 (Itali-Shqipëri-Mali I Zi), dhe udhëhiqet nga Komuna Ostuni (Itali) si Partner Lider.

2. Vlera totale e financimit është 290.929.9 Euro, e konvertuar në lek në shumën 28,269,658 Lekë. Nga të cilat 85% të vlerës (247,290.41 Euro) ose 24,029,209 Lekë do të financohet nga donatori ndërsa 15% e tij (43,639.49 Euro) do të jetë bashkëfinancim i bashkisë, e konvertuar në lek në shumën 4,240,449 Lekë. Gjithashtu, Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e TVSH-së e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori, shuma 4,290,066 lekë, duke arritur në këtë mënyrë buxhetin total të projektit në vlerën 32,559,724 lekë.

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin AE141: “Shërbimet Publike Vendore” sipas detajimit.

Buxheti total në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	949,021	386,700	64,578	497,743		
Shuma 2026	2,562,922	1,546,800	258,312	757,810		
Shuma 2027	28,622,036	1,546,800	258,312	4,126,165		22,690,759
Shuma 2028	425,745	386,700	39,045			
Shuma totale e Projektit	32,559,724	3,867,000	620,247	5,381,718		22,690,759

Buxheti me burim financimi donacion në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	495,761			495,761		
Shuma 2026	752,971			752,971		
Shuma 2027	22,533,679			3,624,713		18,908,966
Shuma 2028	246,798	211,480	35,318			
Shuma totale Financim nga donatori	24,029,209	211,480	35,318	4,873,445	0	18,908,966

Bashkëfinancimi me staf ekzistues në lekë

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	451,278	386,700	64,578			
Shuma 2026	1,805,112	1,546,800	258,312			
Shuma 2027	1,805,112	1,546,800	258,312			
Shuma 2028	178,947	175,220	3,727			
Shuma totale e Bashkëfinancimit	4,240,449	3,655,520	584,929			

**Bashkëfinancimi me burim financimi fondet e veta në lekë
(Shpenzime për TVSH)**

Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të trupëzuara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2025	1,982			1,982		
Shuma 2026	4,839			4,839		
Shuma 2027	4,283,245			501,452		3,781,793
Shuma 2028	0			0		0
Shuma totale e TVSH	4,290,066			508,273		3,781,793

- Bashkëfinancimi me fondet e veta, me vlerë 4,290,066 lekë, do të alokohet në programin **AE141: “Shërbimet Publike Vendore”**, nga të cilat 508,273 lekë për shpenzime operative dhe 3,781,793 lekë për shpenzime kapitale të trupëzuara.
Burimi i financimit do të jetë fonda rezervë për shpenzimet e vitit 2025 (1,982 lekë); ndërsa për shpenzimet me fondet e veta në vitet 2026–2027, ato duhet të parashikohen në fazën finale të PBA 2026–2028.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 40 vota

Vota Pro	40
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	03.11.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Oltion LULLI

